



NEWSLETTER

Janar, 2018.

Nr. 01/2018

Promovohet DVD për arsimimin mediatic, dedikuar shkollave fillore



Në kuadër të përpjekjeve për nxitjen e zhvillimit të arsimit mediatic, Agjencia më 25 janar e promovoi projektin e parë të disa anëtareve të Rrjetit për arsimim mediatic – DVD e dedikuar për shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë. Projekti u financua nga Agjencia, ndërsa u përkrah nga Byroja për zhvillimin e arsimit dhe Ministria e Arsimit, e cila gjatë periudhës së ardhshme do të bëjë distribucionin e DVD-së, nëpër të gjitha shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë.

Siç theksoi drejtori i Agjencisë, d-r Zoran Trajčevski, rëndësia e këtij projekti është e dyfishtë, sepse nga njëra anë, mësuesit fitojnë materiale konkrete me shkrim dhe video prej të cilave mund të inspironen dhe që do të mund t'i shfrytëzojnë si mjete monitoruese me çka arsimimi mediatic në mënyrë më efektive futet në shkollat fillore, kurse nga ana tjetër, bashkëpunimi i Rrjetit brenda dhe jashtë, funksionon ngadalë por me siguri.



Në këtë event fjalë kishin edhe përfaqësuesit e Shkollës së lartë për gazetari dhe marrëdhënie me publik, Konedu global, Evrotink – Qendra për strategji evropiane dhe Avokati i popullit, që folën për përmbajtjen e materialeve me të cilat dhanë kontribut ndaj projektit dhe njëherë edhe shprehën kënaqësinë nga bashkëpunimi i deritanishëm i ndërsjellë. Materialet e DVD-së u siguruan edhe nga Agjencia, Instituti i medieve në Maqedoni, Metamorfozis, OJQ Infoqendra, Transparencë Maqedonia dhe Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut.

Pjesmarrje në Konferencën për pluralizëm politik në medime jashtë fushatës zgjedhore



Në organizim të Institutit të medieve në Maqedoni dhe Këshillit të Evropës, më 24 janar në Shkup u mbajt konferenca kushtuar pluralizmit politik të raportimit mediatic, në periudhën jashtë fushatës zgjedhore. Qëllimi i konferencës ishte që të nxitet një diskutim lidhur me këtë çështje të rëndësishme në mes të faktorëve relevant të vendit dhe duke përfshirë edhe përvojat dhe trendet e vendeve evropiane, të ofrohen rekomandime për avancimin e gjendjes momentale.

Në sesionin kushtuar mekanizmave për promovimin e pluralizmit politik në përmbajtjet mediatic në Maqedoni, fjalë kishte edhe drejtori i Agjencisë, d-r Zoran Trajčevski, i cili potencoi kornizën juridike të rregullatorit si dhe aktivitetet e deritanishme të Agjencisë lidhur me këtë çështje, si dhe rekomandimet për nxitjen e pluralizmit politik në medime. Një pjesë e rekomandimeve kishin të bëjnë edhe me respektimin e standardeve politike – në kontekst të sigurimit të pluralizmit politik; organizimin e debateve, tryezave të rrumbullakta si dhe punëtorive ku do të prezantohen përpjekjet e përbashkëta të të gjithë faktorëve të bashkësisë mediatic; medimet të sgurojnë një prezantim të shumëllojshëm të grupeve të ndryshme politike dhe ideologjike, përfshirë edhe qëndrimet dhe interesat e minoriteteve, si dhe të sgurojnë një trajtim të barabartë të pasqyrimeve të ndryshme politike.



Pjesmarrësit e tjerë në këtë event, e potencuan rëndësinë e vetë rregullimit në medime dhe ndërtimin e sistemit për mbrojtje të pluralizmit politik, kurse një pjesë e diskutimit i përfshiu edhe përvojat nga vendet evropiane në drejtim të pluralizmit politik në përmbajtjet mediatic.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Të dhënat për shtrirjen e radiostacioneve si dhe për ndikimin në shikueshmërinë e përgjithshme të stacioneve të TV – Raporti vjetor për vitin 2017 dhe për kuartalin e katërt të vitit 2017.

Për nevojat e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale u përpiluan dy raporte me të dhënat për shtrirjen e radiostacioneve si dhe për ndikimin në shikueshmërinë e përgjithshme të stacioneve televizive - Raporti vjetor për vitin 2017 si he raporti për kuartalin e katërt të vitit 2017.

Të dy raportet mund të merren në ueb faqen e Agjencisë www.avmu.mk.

Mbikëqyrja e radiodifuzerëve

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale realizoi mbikëqyrje të rregullt programore ndaj TV Kanal 5, TV Sitel, TV Telma, TV Alsat-M, TV Alfa dhe Radiotelevizionit të Maqedonisë RTM 1, lidhur me dispozitat ligjore për obligimet - prodhim vjetor dhe emetim të programit prej së paku 10 orëve, kurse shërbimi publik i radiodifuzionit së paku me 30 orë program dokumentar vendas në periudhën nga ora 7:00 deri në 23:00 si dhe obligimin për prodhim vjetor si dhe emetim të së paku 20 orëve, kurse për shërbimin publik së paku 30 orë të programit artistik vendas në periudhën nga ora 7:00 deri në 23:00. Me mbikëqyrjet u konstatua se radiodifuzerët kanë vepruar sipas dispozitave të LSHMAA.

U realizua edhe një mbikëqyrje kontrolluese administrative ndaj Radio Llav nga Ohri, lidhur me obligimet që në programin e tyre të publikohen të dhëna për strukturën pronësore, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit nga viti i kaluar dhe një incizim i publikimit të dorëzohet në Agjenci. Mbikëqyrja tregoi se është vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit për medime.


Mbikëqyrja e medimeve të shtypit

Agjencia realizoi mbikëqyrje kontrolluese administrative ndaj INDEPENDENT BALKAN NJUS, publikues i gazetës "Nezavisen", me qëllim që të konstatohet nëse pas masës së shqiptuar të vërejtjes, e ka plotësuar obligimin për të siguruar në vend të dukshëm për çdo përmbajtje, të dhënat e selisë, personave përgjegjës dhe redaksinë e publikuesit të mediumit, të dhëna për shtypshkronjën, datën e botimit ose ribotimit si dhe numrin e kopjeve të botuara. Mbikëqyrja tregoi se është menjanuar shkelja e bërë më heret sipas Ligjit për medime.

Mbikëqyrja e operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale realizoi mbikëqyrje të rregullt programore ndaj operatorëve kabllor Transhpedit Trejd nga Shkupi, Biv Piramida nga Dellçeva, Inel Internacional nga Kavadari dhe Globalsat nga Shkupi, në lidhje për vetëm disa obligime ligjore - ritransmetim të shërbimeve programore me pornografi vetëm në formë të koduar, titrimin në maqedonisht ose në gjuhën e bashkësisë joshumicë në RM, regjistrimi i shërbimeve programore nga Agjencia dhe ritransmetimi i shërbimeve programore vetëm në zonën e shërbimit për të cilën radiodifuzerët kanë leje për transmetim të radios ose televizionit. Mbikëqyrja tregoi se nuk janë konstatuar shkelje.

Për të njëjtat dispozita ligjore, Agjencia realizoi edhe një mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore ndaj Total TV Shkup, ku u konstatua se operatori kabllor për shfrytëzuesit e tyre ka ritransmetuar shërbime programore që nuk janë të përfshirë me vërtetimet për regjistrimin e shërbimeve programore të Agjencisë. Për këtë shkelje i është shqiptuar masa e vërejtjes, me urdhëresë për ç'kyçje të ritransmetimit të shërbimeve të kontestueshme programore.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup

Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401

e-posta: contact@avmu.mk ueb faqja: www.avmu.mk



MKC EN ISO 9001:2009

MKC EN ISO 9001:2009